



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
Mbledhja nr. 18
Prishtinë, më 21 shtator 2010, në orën 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Kosara Nikoliq, Gani Koci, Naser Osmani, Riza Smaka, Synavere Rysha, Enis Kervan.

Munguan: Anita Morina-Saraçi

Të ftuar: Lage Olofsson – auditor i përgjithshëm - ZAP.

Të pranishëm: Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Fatime Qorri - zyrtare ligjore, Musa Rudaku – zyrtar i fushës së ekonomisë dhe të financave, KIPRED (staf mbështetës) - Artan Venhari dhe Albert Krasniqi, Shpresa Miftari – praktikante, Qëndresa Mulaj – ZAP dhe Jusuf Zejna – KDI.

Mbledhjen e kryesoi Haki Shatri - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të 06. 07. 2010 dhe të 13. 07. 2010;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit për vitin 2009 – Zyra e Auditorit të Përgjithshëm;
4. Të ndryshme:
 - a) Njoftim për përgjigjen e ZAP-it lidhur me kërkesën e KMFP-së për Raportin e auditimit të menaxhimit financiar të NQ “TERMOKOS” Prishtinë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009;
 - b) Njoftim lidhur me zbatimin e rekomandimeve për KQZ-në, të dhëna në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009;
 - c) Njoftim lidhur për veprimet e ndërmarra nga institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e rekomandimeve në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2009;
 - d) Njoftim lidhur me planin e implementimit të rekomandimeve të ZAP-it lidhur me Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të sh.a. KUR “Prishtina”.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 06. 07. 2010 dhe 13. 07. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i miratoi procesverbalet mbledhjeve të 06. 07.2010 dhe të 13. 07. 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të auditimit për vitin 2009 – Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Kryesuesi – I ftoi përfaqësuesit e ZAP-it ta paraqitnin Raportin.

Gani Koci – Raporti është përmbledhje e raporteve buxhetore të veçanta. Duhet pasur kujdes me terminologjinë që përdoret, sepse mund të ketë lajthitje me opinionet lidhur me këto raporte. P.sh. *“opinion i pakualifikuar – ka kuptimin pozitiv dhe i kualifikuar- ka kuptimin negativ”*. Në përgjithësi u pajtua me Raportin dhe kërkoi që ZAP-i të jetë shumë konsekuent në përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve që dalin nga ky Raport.

Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm – ZAP – Konkluzioni kryesor në këtë Raport është që Pasqyrat Financiare të buxhetit të Kosovës, në të gjitha aspektet materiale, të konsiderohen të vërteta dhe të drejta. Janë vërejtur disa mangësi në lidhje me cilësinë e informacionit në këtë Raport. Notat në Pasqyrat Financiare duhet të jenë më transparente. Kjo d.m.th. që kur kemi të bëjmë me mënyrën si Qeveria i ka përdorur instrumentet financiare, është e vështirë të kuptohet se cilat kanë qenë veprimet financiare, kur i lexojmë Pasqyrat Financiare. Gjendja në komuna, në përgjithësi, është shumë shqetësuese sa u përket menaxhimit financiar dhe kontrollit. Qeveria duhet ta nisë një program specifik për ta tejkaluar situatën, në të cilën jemi tani. Edhe pse janë ndërmarrë hapa për një vit e gjysmë, që ka kaluar, sa u përket rregullimit financiar dhe kontrollit, zbatimi aktual i menaxhimit financiar në Kosovës duhet të forcohet. Mënyra si punon Qeveria për të nxitur një menaxhment më të mirë, duhet të zhvillohet gjithashtu. Sot ato duhet të fokusohen në rregulloret, në udhëzimet administrative dhe në ligjet. Që të kemi menaxhment më të mirë duhet të kemi shembull të mirë, praktika më të mira dhe diskutime për atë që janë duke bërë dhe për qartësimin e përgjegjësisë të menaxherëve. Sa u përket mjeteve qendrore dhe implementimit lokal, auditimit të brendshëm, prokurimit, zyrtarit certifikues, trajtimit të aseteve, paraqitjes së qeverisjes elektronike, në të gjitha këto fusha duhet të forcohemi, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror. Sa i përket forcimit të qeverisjes së mirë, edhe pse ka filluar procesi që menaxherët të japin llogari rreth asaj çka janë duke bërë, ka ende shumë për t'u bërë. Duhet të sigurojmë që mjetet administrative, që i kemi për ta luftuar performancën e dobët, të përdoren sipas mënyrës për të cilën ato janë planifikuar. Ligji për ndërmarrjet publike duhet të ndryshohet. Auditorët në këto ndërmarrje duhet të caktohen nga pronarët e jo nga përfaqësuesit e këtyre institucioneve. Duhet të merren masa për një dialog më të mirë ndërmjet Kuvendit dhe institucioneve të pavarura. Po ashtu duhet t'i kemi disa propozime nga Qeveria se ky proces buxhetor duhet të kryhet nga ana e tyre. Gjithashtu të sigurohet që pavarësia e këtyre institucioneve të jetë fakt.

Riza Smaka - Materiali është i përgatitur jashtëzakonisht mirë. Por, brengosin konkluzionet – faktet që i ka konstatuar auditori i përgjithshëm. Ato kryesisht paraqesin parregullsi, paligjshmëri dhe papërgjegjshmëri. Në këto konkluzione dalin shumë abuzime. P.sh. fq. 1 *“në disa prej komunave ekzistojnë probleme të kontabilitetit në përgjithësi”*, ndoshta do të ishte më mirë të theksohej se për cilat komuna është fjala. Kontrolli i brendshëm *“mospërputhje me kornizën legjislative”* – kjo d.m.th se punohet kundër ligjit. Kjo do të duhej të ishte pikënisje e prokurorisë publike, sepse kur s'ka përputhje me kornizën ligjore atëherë ka shkelje të shumta. Fq 5 *“të*

forcojë rutinë mbi kontratat me pagë”, d.m.th. s’ka rregulla të konfirmuara sa u përket kontratave. Ka shumë kontrata fiktive, d.m.th. ka kontrata arbitrarisht jashtë rregullave për paga. “Prezantimi jo i duhur dhe i pasaktë i pasurisë financiare të organizatave buxhetore”, si mund të lejohet kjo në një shtet në shekullin XXI? “Organizatave buxhetore nuk janë duke vepruar sa duhet lidhur me të gjeturat dhe me rekomandimet e auditimit”, d.m.th. organizatat buxhetore nuk i kanë marrë për bazë këto rekomandime, që të riorganizoheshin dhe të raportonin për veprimet e ndërmarra lidhur me lëshimet e konstatuara. Lidhur me kornizën legjislative për institucione të pavarura - çdo institucion do të duhej të dinte se çfarë akti ligjor do t’i duhej. Duhet të merren nisma ose duhet të jepen ide, pastaj të kemi procedura për to. Fq. 10. “pasqyra e pranimit dhe e pagesave në para të gatshme, mosregjistrimi i transaksioneve në kodet ekonomike adekuate”, janë fshehje e transaksioneve. “Shumica e komunave nuk kanë sistem të pagave për të gjitha departamentet e tyre”. Fq. 12 “mangësia sa u përket procedurave të zbatuara ligjore dhe kriterëve të aplikuara për rialokimin e fondeve” etj., d.m.th. nuk bëhet alokimi sipas kriterëve. Qëndrimet e Komisionit duhet të jenë shumë serioze.

Synavere Rysha – Raporti është i pasqyruar drejtë dhe është përmbajtjesor. Nga Raporti shihet se performanca e institucioneve është në nivel të ulët. 70 auditime që i ka bërë auditori në vitin 2009, krahasuar me numrin e auditimeve, që janë bërë në vitin 2008 (25 auditime), është për t’u vlerësuar. Situata nëpër komuna është shqetësuese sa u përket informatave financiare, sidomos ekzekutimit të buxhetit. 16 % e buxhetit nuk është realizuar. Kjo është performancë jo e mirë. Raporti vjetor i përfshin katër raporte me “*opinion i kualifikuar*” dhe pikërisht në këto raporte duhet të fokusohet KMFP-ja. Janë 15 të pakualifikuara, 16 të pakualifikuara, por me theksim të çështjes, 29 mohime të opinionit dhe dy opinione të kundërta. Pasoja e buxhetit dhe shuma aktuale - ekziston një trend për shpenzime të larta në fund të vitit. Kësaj duhet t’i përkushtohemi si Komision. Pse ndodh që në fund të vitit gjendet forma për shpenzim të buxhetit? A do të thotë kjo që nuk po bëhen planifikime me kohë për realizimin e mjeteve?

Safete Hadergjonaj – Vërehet se auditori ka filluar t’i ngritë kapacitetet e veta. Ka bërë më shumë auditime, ka përmirësime në Raport, edhe pse ka edhe disa gjëra të parëndësishme të paraqitura në të, p.sh përcaktimi i kompetencave, që është përcaktuar me ligje. Shqetësuese janë rekomandimet, të cilat duhet të zbatohen, sepse të metat e identifikuar në vitin paraprak - të identifikohen sërish, krijojnë përshtypjen se këto gabime po bëhen me qëllim. Janë bërë auditime të 33 komunave, mirëpo ky është një numër i vogël, sepse me kontratë janë paraparë 29 auditime nga kompanitë private audituese, ndërsa vetëm 4 komuna janë audituar nga auditori i përgjithshëm. Megjithatë, është bërë punë e mirë, sepse, sidomos, në Komuna ka ngecje të mëdha në zbatimin e rekomandimeve. Nga 230 rekomandime, nuk është logjike të jenë zbatuar vetëm 40. Këtu duhet të fokusohet Komisioni, të organizojë dëgjime publike etj. Tek institucionet e pavarura, më tepër ka konstatime të përgjegjësisë. Është kërkuar nga ne që institucionet e pavarura të kenë mjetet që ato i kërkojnë. Ne jemi përpjekur që këtyre institucioneve ashtu sikurse Zyrës së Auditorit tu krijojmë kushte, megjithatë mbetet shumë për tu bërë që këto institucione të kenë pavarësinë. Mirëpo, këtu problemi është më i thellë, sepse këto institucione duhet t’i ngrisin kapacitetet e veta që të dinë t’i fusin në funksion financat e tyre. Pra, ka mungesë kapacitetesh në planifikim dhe në zbatim të buxhetit. Te ndërmarrjet publike, është e rëndësishme të dihet pse auditori nuk është orientuar në auditimin e ndonjë ndërmarrjeje të madhe publike, që ka qenë shumë e diskutueshme, si p.sh KEK-u. Problemi kryesor është se këto ndërmarrje publike kanë qenë nën menaxhim të institucioneve të jashtme. Këto ndërmarrje, që në bazë të auditimit të futen në sistem - duhet t’u raportojnë institucioneve vendore. Institucionet ende nuk po mund ta tejkalojnë problematikën e punës së punëtorëve me kontratë. Është një problem që po përcillet me vite, sikurse edhe problemi i regjistrimit të pasurisë. KMFP-ja me dëgjimet publike, që do t’i organizojë, do të fokusohet në këto probleme.

Kosara Nikoliq – Raporti është i mirë dhe përmbajtjesor. Në vija të përgjithshme i pasqyron vërejtjet që kanë të bëjnë me mosfunksionimin e kontrollit të brendshëm në të gjitha organizatat buxhetore, me moszbulimin e pasurisë fikse për evidencimin e pasurisë si dhe për furnizimin të cilat nuk kanë qenë në përputhshmëri me ligjin përkatës. Rekomandimet e auditorit nga vitet e

kaluara janë respektuar 50%. Gjendja do të jetë e njëjtë edhe në këtë Raport. Auditori duhet të fokusohet në kontrollin e zbatimit të këtyre rekomandimeve. Lus auditorin që ta kemi një raport edhe më të mirë në zbatimin rekomandimeve.

Naser Osmani – Tha se Raporti është përmbledhje e përgjithshme. Siç është nuk mjafton për deputetët, sepse duhet një pasqyrë më e qartë për gjendjen nëpër institucionet e vendit. Ndoshta do të ishte më mirë që çështjet - shfrytëzuesit e buxheteve, sipas natyrës specifike - të ishin ndarë në grupe, sepse në disa momente krijohen ngatërime. P.sh. shpjegohet për AKP-në, ndërsa rekomandimet janë dhënë për ndërmarrje publike. Deputetëve u intereson në cilat dukuri Qeveria ka probleme, cilat janë problemet, në të cilat Qeveria nuk arrin ta përmirësojë performancën e shpenzimeve të buxhetit, cilat janë komunat që nuk kanë progres në përmirësimin e financave, ku dhe në cilat segmente duhet të plotësohet korniza ligjore? Nga ky Raport shihet se nuk ka problem në buxhetin e Kosovës, ndërsa në praktikë ka shumë probleme, siç është çështja e prokurimit dhe cilat janë ato organizata që kanë probleme në këtë drejtim? Një mungesë e madhe është çështja e Bankës Qendrore, lidhur me lëvizjen e mjeteve dhe me ekonomizimin e tyre.

Kryesuesi – Raporti ka elemente të mjaftueshme për t'u mbështetur nga Komisioni. Raportet individuale janë të publikuara në faqen e internetit të ZAP-it. Komision do të bëjë përpjekje që të ndahen organizatat buxhetore, që karakterizohen me më shumë shkelje, që të jenë objekt shqyrtimi në ditët që vijnë. Auditimi i Pasqyrave Financiare është vetëm një aspekt i auditimit dhe nuk jep përgjigje nëse përdorimi i parasë publike është bërë me efektshmëri. Rekomandim për ZAP-in do të ishte që në të ardhmen, në programin e punës, të parashohë auditime të performancës të organizatave buxhetore. Ne kemi parë se Raporti paraqet mangësi si: mosreagimi në gjetjet e Raportit nga viti 2008. 170 rekomandime nuk janë përfillur. Kjo tregon për mosgatishmëri të organizatave buxhetore për evitimin e gjetjeve. Në procesin e prokurimit ka shkelje të mëdha - prej mënyrës së shpalljes së tenderit e deri të implementimi i kontratave. Punësimi ka gjetje: procedurat e shpalljes, mënyra e rekrutimit, pagesa jashtë kontrate, mospërputhja e pagesave në regjistrin kryesor dhe e shumave të thesarit. Pajtohem me mendimin që auditori të orientohet në auditimin e ndërmarrjeve publike, që kanë peshë më të madhe, që kanë më shumë qarkullim të parasë publike, si PTK-ja, KEK-u, Aeroporti etj. Propozoj që Komisioni t'i rekomandojë Kuvendit, që bashkë me miratimin e këtij Raporti, të përqendrohet edhe në këto çështje: *Qeveria të marrë masat e duhura për të siguruar cilësi më të mirë të informacionit; qeveria të marrë masat e duhura për të ndihmuar në zhvillimin e menaxhmentit financiar dhe të kontrollit brenda organizatave buxhetore; të merren masat e duhura për qeverisjen më të mirë; Qeveria do të raportojë mbi masat e ndërmarra rreth këtyre pikave dhe rreth të gjeturave të auditorit dhe ta kthejë raportin në Kuvend deri në mars të vitit 2011.*

Gani Koci – ZAP-i është ai që duhet ta përcjellë nëse Qeveria po i përfill rekomandimet e auditorit. Komisioni nuk mund të caktojë afate për asnjë institucion. Raporti i auditorit së pari i procedohet Qeverisë, pastaj i kompletuar procedohet në Komision. Rekomandimet janë dhënë për secilin institucion. Komisioni nuk mund të kërkojë nga Qeveria raport në mënyrë të përgjithshme. Komisioni mund të kërkojë raport për masat e ndërmarra nga institucionet e veçanta.

Safete Hadergjonaj – Auditori i përgjithshëm ka dhënë sugjerime se ku duhet të fokusohemi. Komisioni ka mundësi t'i ftojë të gjitha organizatat buxhetore për këto të gjetura të auditorit, por nuk mund ta përgjithësojë çështjen dhe të kërkojë raport nga Qeveria.

Synavere Rysha – Nga Raporti shihen katër opinione “të kualifikuara”, pra janë katër institucionet, në të cilat situata është skandaloze. Komisioni duhet të fokusohet në këto katër institucione. Orientimi i Komisionit duhet të jetë në ZAP. Nëse kërkojmë raport të përgjithësuar nga Qeveria, kjo do të ishte vetëm formale. Ne duhet të fokusohemi në këto katër institucione, për të cilat opinioni është i kualifikuar. Në radhë të parë Komisioni duhet të orientohet në KQZ. Nëse vota e qytetarit po manipulohet, si mund të flasim për çështje të tjera? Ndoshta edhe ne që

jemi në pushtet jemi më të manipuluar? Jemi 120 deputetë që po e sfidojmë dhe po e sjellim Kosovën në këtë gjendje.

Kryesuesi - Pas Raportit të përgjithshëm, Komisioni do t'i ndajë institucionet me të cilat do të merret. Pra, Komisioni do të vendosë se me cilat institucione do të merret. Kuvendit duhet t'i rekomandohet të kërkojë nga Qeveria raport kthesë që të marrë masa për të gjeturat e auditorit. Raporti flet për vitin 2009. Prej janarit organizatat buxhetore kanë pasur kohë t'i eliminojnë të gjeturat në këtë Raport.

Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm – ZAP – Qeveria duhet të përgjigjet çka ka bërë në lidhje me vendimet e Kuvendit për sa i përket Raportit vjetor të auditimit. Është praktikë e mirë që Qeveria ta ketë përgjegjësinë të deklarojë çka ka ndërmarrë lidhur me këtë çështje.

Gani Koci - Qeveria bën raporte periodike tremujore, gjashtëmujore dhe raporte vjetore në Kuvend. Kjo është përcaktuar qartë me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Në këtë Komision po kërkohet çka do të bëjë Qeveria për ta përmirësuar këtë problematikë. Rekomandimet në këtë Raport janë individuale. Komisioni duhet të fokusohet në ato institucione në të cilat gjendja është më e keqe.

Kosara Nikoliq – ZAP-i në këtë Raport ka bërë rekomandime për organizatat buxhetore. Puna e auditorit të përgjithshëm nuk përfundon me dhënien e rekomandimeve, por edhe me kontrollin që rekomandimet të kalojnë në vepra.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja njëzëri vendosi që Kuvendit t'i

REKOMANDOJË

Të miratohet Raporti vjetor i auditimit për vitin 2009, me rekomandime, i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

4. Të ndryshme

a) Njoftim për përgjigjen e ZAP-it lidhur me kërkesën e KMFP-së për Raportin e auditimit të menaxhimit financiar të NQ “TERMOKOS” Prishtinë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009

Kryesuesi – ZAP- i ka bërë shkresë, me të cilën është përgjigjur lidhur me kërkesën e KMFP-së për një auditim të ri të menaxhimit financiar të NQ “TERMOKOS” Prishtinë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009, me një ekip tjetër auditues. Sipas shkresës së ZAP-it, auditori garanton vërtetësinë e raportit të proceduar për shqyrtim në këtë Komision.

Gani Koci – Përgjigjja e ZAP-it në këtë formë është e papranueshme, sepse Komisioni nuk e ka shqyrtuar vërtetësinë e Raportit. Ky Raport është refuzuar, sepse ekipi i auditimit ka mund të jetë subjektiv. Personi që e ka udhëhequr auditimin ishte i punësuar në TERMOKOS dhe është larguar nga kjo ndërmarrje si pasojë e keqpërdorimeve, për të cilat po zhvillohen hetime në institucionet e hetuesisë. Ai akuzohet për keqpërdorime të më se 70 mijë eurove. Arsyeja tjetër ishte se në të njëjtin ekip ka marrë pjesë personi që ka konkurruar në TERMOKOS dhe është tërhequr. Kjo çon në konstatimin se ky Raport nuk mund të pranohet, sepse ka konflikt interesi. Auditori duhet ta zbatojë kërkesën e Komisionit. Raporti është refuzuar nga ky Komision dhe është kërkuar një auditim i ri me një ekip tjetër auditues.

Kryesuesi – Tha se nuk dyshon në vendimet dhe në sinqeritetin e ZAP-it. Meqenëse auditori garanton se Raporti është i saktë, duhet të pranohet ashtu siç është.

Safete Hadergjonaj – Nuk kemi vërejtje në Raport, mirëpo nuk bën që një person, i cili ka dosje në gjykatë të bëjë auditim pikërisht në institucionin nga i cili është përjashtuar nga puna. ZAP-i ka pasur auditorë të tjerë për ta bërë auditimin. Dua t'i besoj ZAP-it, por si është e mundur të pranohet në ZAP një person që ka bërë shkelje të një natyre të rëndë, sipas të provave që i kemi në dispozicion?

Riza Smaka – Raporti mund të jetë shumë i saktë, mirëpo për shkak se një nga anëtarët e ekipit auditues mund të dyshohet, me bazë se ka qenë subjektiv, nuk është dashur të përqendroheshim në saktësinë ose në jo saktësinë e këtij Raporti. Personit në fjalë kontrata iu ka shkëputur për shkak të shkeljeve. Ne si Komision duhet të kërkojmë që punët të kryhen sipas ligjit. Pajtohem plotësisht me pikëpamjen e deputetit Gani Koci lidhur me këtë çështje.

Kosara Nikoliq – Konstatoj se njëri prej këtyre anëtarëve është dashur të përjashtohet, sepse lind dyshimi se të dhënat e këtij personi nuk janë të sakta. Personi që ka punuar në këtë ndërmarrje, ka mundur të bëjë raport që nuk përputhet me gjendjen reale. Nuk mund ta pranojmë përgjigjen e ZAP-it lidhur me këtë çështje.

Synavere Rysha – Nuk ishte e mendimit që Raporti të refuzohet në dëgjimin publik. Të njëjtin mendim e ka edhe tani. Kanë kaluar tre vjet, nga koha kur auditori, që e ka kryer auditimin ka punuar në këtë institucion. Kjo në bazë të ligjit nuk paraqet pengesë. Ndjekja penale ka filluar pasi ka filluar auditimi në TERMOKOS. Pse ka ndodhur kjo pas pesë vjetësh? Një fakt tjetër që e kam kuptuar më vonë është se njëra nga udhëheqëset që është anëtare në PDK, ka qenë kandidate në zgjedhje. Këto janë tri elemente që e bëjnë të dyshojë. Raporti ka elemente të mjaftueshme për t'u debatuar.

Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm – ZAP – Me letrën jam munduar t'ju them se ne kemi standardet ndërkombëtare për sa i përket kodit të mirësjelljes dhe ne i përmbahemi atyre. Qysh në fillim kur kemi filluar me këtë auditim ne na është bërë pyetja nëse ne kemi të drejtë të bëjmë këtë auditim. Pasi kemi filluar me auditimin na janë bërë pyetje të tjera psh: njerëzit që i kemi pasur në auditim. Kjo çështje nuk u denoncua në Gjykatë para se ne të shkonim për të bërë auditimin. Dhe nuk ka pasur asnjë lloj kontakti zyrtar me mua.

Gani Koci – Tha se ZAP ka pyetur në Prokurori dhe ka marrë informatën se personi i cili është duke udhëhequr me auditimin, është duke u hetuar. A keni marrë ndonjë masë pasi që keni marrë këtë informatë?

Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm – ZAP – Ky person ka qenë nën hetime, por pasi që ka filluar auditimi. Nuk janë marrë veprime në vitin 2006, 2007, 2008, por në vjeshtën e vitit 2009, domethënë pasi që ne kemi filluar auditimin. Kjo nuk ka ndikim në atë çka ne kemi bërë. Puna e këtij ekipi është kontrolluar dhe monitoruar për nga cilësia dhe janë përfshirë tetë persona dhe e gjithë puna përfundon pastaj të unë. Ne mund të kërkojmë nga Termokos, nëse janë përmbushur rekomandimet.

Gani Koci – Komisioni e ka refuzuar këtë raport dhe ju nuk mund të kërkonit a janë përmbushur rekomandimet. Komisioni kërkon që të bëhet raport i ri i auditimit.

Kryesuesi – Pyeti: sa kohë i duhet auditorit për të bërë një auditim të ri, me një ekip tjetër audituese?

Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm – ZAP – Kjo është çështje Kushtetuese. Jam i pavarur edhe nga ky Komision. Nëse nuk keni besim në mënyrën e punës si auditor i përgjithshëm, atëherë këtë çështje mund ta ngritni në Kuvend.

Gani Koci – Në veprimet e tua ju jeni plotësisht i pavarur, por nëse nuk mund të rekomandojmë se çka duhet bërë, atëherë pse duhet të shqyrtojmë këto raporte, pse duhet të ekzistoj ky Komision. Ju jeni përgjegjës para këtij Komisioni dhe para këtij Kuvendi.

Kryesuesi konstatoi se KMFP-ja, me shumicë votash e kërkon nga auditori i përgjithshëm auditimin e menaxhimit financiar të NQ “TERMOKOS” Prishtinë, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009, me një ekip tjetër audituese.

Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm – ZAP – Lidhur me kërkesën e Komisionit tha se auditimi do të bëhet me një ekip tjetër që të shihet si i ka menaxhuar gjërat TERMOKOS-i për vitin 2010. Në ndërkohë do t'i kthehen edhe kësaj periudhë për të cilën kërkon Komisioni.

b) Njoftim lidhur me zbatimin e rekomandimeve për KQZ-në, të dhëna në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009

Kryesuesi i njoftoi anëtarët e Komisionit se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka proceduar në Komision shkresën lidhur me zbatimin e rekomandimeve për KQZ-në, të dhëna në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009, në bazë të kërkesës së KMFP-së të datës 30 qershor 2009. Ky njoftim do t'u dërgohet për shqyrtim deputetëve në mbledhjen plenare së bashku me Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009 dhe me rekomandimin e Komisionit.

c) Njoftim lidhur me veprimet e ndërmarra nga institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me zbatimin e rekomandimeve në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2009

Kryesuesi i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit, sipas Raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2009, në bazë të rekomandimit të Komisionit të datës 30 qershor 2010.

d) Njoftim lidhur me planin e implementimit të Rekomandimeve të ZAP-it lidhur me Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të sh.a. KUR “Prishtina”

Kryesuesi i njoftoi anëtarët e Komisionit për planin e implementimit të rekomandimeve të ZAP-it, lidhur me Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të sh.a. KUR “Prishtina”, në bazë të rekomandimit të Komisionit të datës 30 qershor 2010.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Haki Shatri